

Thirrje për aplikime për bashkëpunëtor të jashtëm/ Konsulent (ekspert të fushës)

Autoriteti i Konkurrencës kërkon ekspert për studim tregu në sektorin bankar.

Pasi zhvilloi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: **Shërbim konsulence- për studim tregu në sektorin bankar** në adresën www.app.gov.al në datën 02.10.2015, ora 11:00 dhe në datën 05.10.2015, ora 14:00, nuk u paraqit asnjë operator ekonomik. Në këtë rast, duke qënë se procedura është anuluar dy herë rradhazi, do të vijohet me realizimin e procedurës në rrugë shkresore sipas procesverbalit nr.6.

Të interesuarit të dërgojnë ofertën e tyre (deri në 166 667 lekë) deri në datën 16 tetor 2015 në adresën *Rruga Sami Frashëri, Nr. 4, kati IV, Tiranë. Tel +355 4 2234504, fax: +355 4 2234497*

Fushat e ekspertizës së kërkuar:

- Njohuri të thella të sektorit bankar, kryesisht të sistemeve të informacionit për shërbime bankare për individë, biznese dhe korporata (retail and corporate banking); Kredisë, Riskut financiar, Manaxhim portofoli, Analizës financiare, Auditim, Kërkime tregu, Ekonomiks.

Kohëzgjatja e shërbimit: Tetor 2015 – deri në hartimin e raportit përfundimtar të studimit të tregut.

Përshkrimi i punës:

1. Ndarja e njohurive dhe eksperiencës me Grupin e Punës gjatë realizimit të studimit të tregut në sektorin bankar;
2. Ofrimi i këshillave dhe sugjerimeve të nevojshme për hartimin e metodologjisë së ndjekur gjatë studimit dhe ndërtimit të pyetësorëve/ procesverbaleve për marrje shpjegimesh;
3. Marrja pjesë në takime të realizuara nga Grupi i Punës me aktorë të ndryshëm në këtë treg.
4. Hulumtimi i praktikave të ngjashme në nivel europian ose më gjerë;
5. Asistencë në hartimin e raportit final të studimit të tregut në sektorin bankar.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare dhe pas- universitare në Ekonomi.
- Eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet nga të cilët jo më pak se 5 vjet në sektorin bankar.
- Punë të ngjashme të kryera në studime apo publikime (të vërtetuara).
- Aftësi të mira në komunikim dhe në punën në grup.
- Aftësi të mira në kompjuter apo programe të përdorura në sektorin bankar.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar të cilët përmbushin kualifikimet e kërkuara duhet të dorëzojnë aplikimin e tyre në përputhje me termat e referencës të përcaktuara në këtë njoftim.

Aplikimet duhet të përmbajnë:

- Curriculum Vitae në formatin European.
- Letër interesi të firmosur.
- Kopje diplome të studimeve universitare dhe pasuniversitare të noterizuara.
- Kopje të kontratave për punë të ngjashme